

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT - VENDIM

Nr. 06, Date 03/06/2024

Për miratimin e Projektit:

MIRATIMI I FONDIT SOCIAL 2024

“PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE DHE RITJA E MIRËQENJES SOCIALE PËR FËMIJËT ME AK NË DIBËR”

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr. 121/2016 për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë, dhe Planin Social 2024-2027 të miratuar nga Bashkia Dibër.

Kërkojmë:

1. Miratimin e projektit “Përmirësimi i shërbimeve dhe ritja e mirëqenjes sociale për fëmijët me AK në Dibër” të financuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me një vlerë 4, 515, 000 lekë.
2. Bazuar në draft marëveshjen e projektit si dhe komunikimet periodike me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 90% e vlerës (4,515,000 lekë) të projektit do Fiancohet nga Ministria dhe 10% e vlerës (451,500 lekë) të projektit do të financohet nga Bashkia Dibër.
3. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Sektori i Prokurimeve.

Për Bashkinë Dibër:


Drejtorja e Shërbimeve Publike
Z. Bedri Kamberi

Drejtorja e Kujdesit Social
Z. Abedin Paçi

Drejtorja Ekonomike
Zj. Çeljeta Zuna

Drejtorja Juridike
Z. Ismet Saraçi

KRYETARI I BASHKISË
Rahim SPAHIU



Buxheti i detajuar

Emërtimi i Projektit: PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE DHE RITJA E MIRËQENJES SOCIALE PËR FËMIJËT ME AK NË DIBËR
 Kohëzgjatja e projektit: 36 muaj
 Bashkia: Dibër

Viti i Parë

| Partnerët | Totoli i projektit | MMSSH (Fondi Social) | Bashkia Dibër | Kosto për njësi / Lek | Kosto Total /lek | Kontributi i kërkuar nga Fondi Social | Kontributi i veti i Bashkisë | Partneri |
|------------|--|--|---------------|------------------------------|-------------------------|--|-------------------------------------|-----------------|
| Buxheti | 4,966,498 | 4,515,000 | 451,498 | | | | | |
| No. | Cost Items | Njësia (p.sh. pjesë, orë pune / ditë, muaji i personit, muaji, viti, përmbledhje) | Sasia | Kosto për njësi / Lek | Kosto Total /lek | Kontributi i kërkuar nga Fondi Social | Kontributi i veti i Bashkisë | Partneri |
| 1 | Burimet njerëzore | | | | | | | |
| 1.1 | Punonjës sociale me kohë të plote | muaj | 11 | 75,000 | 825,000 | 825,000 | - | - |
| 1.2 | Psikolog me kohë të plote | muaj | 11 | 75,000 | 825,000 | 825,000 | - | - |
| 1.3 | Fizioterapist me kohë të plote | muaj | 11 | 75,000 | 825,000 | 825,000 | - | - |
| 1.4 | Logopedist me kohë të plote | muaj | 11 | 75,000 | 825,000 | 825,000 | - | - |
| 1.5 | Shoferi me kohë të plote | muaj | 11 | 55,000 | 605,000 | 605,000 | - | - |
| | Sub total | | | | 3,905,000 | 3,905,000 | - | - |
| 2 | Bashkëfinancimi në asete për Njësine Lëvizëse | | | | | | | |
| 2.1 | Materiale për mbajtjen dhe organizimin e planeve zhvillimore | muaj | 11 | 14,159 | 155,749 | - | 155,749 | - |
| 2.2 | Mirëmbajtje e qendrës multifunksionale (qendra operative e njësisë lëvizëse) | muaj | 11 | 14,159 | 155,749 | - | 155,749 | - |
| | Sub total | | | | 155,749 | - | 155,749 | - |
| 3 | Shpenzimet për aktivitetet (sipas planit të punës) | | | | 311,498 | - | 311,498 | - |
| 3.1 | Trajnime dhe Specializime për stafin e rekrutuar. | shërbime | 2 | 100,000 | 200,000 | 100,000 | 100,000 | - |
| 3.2 | Takime me institucionet lokale për rritësimin e fëmijëve me AK në komunitet. | shërbime | 4 | 25,000 | 100,000 | 100,000 | - | - |

| | | | | | | | | |
|-----|---|----------|----|---------|------------------|------------------|----------------|----------|
| 3.3 | Aktivitetë të ndryshme të cilat adresojnë problematikat që lidhen me AK. | shërbime | 2 | 100,000 | 200,000 | 200,000 | - | - |
| 3.5 | Uniforma dhe veshtjere profesionale për stafin e njësisë tëvizisë. | copë | 10 | 7,000 | 70,000 | 30,000 | 40,000 | - |
| 3.2 | Shpenzime operative për transport (karburant) | muaj | 12 | 15,000 | 180,000 | 180,000 | - | - |
| | Sub total | | | | 750,000 | 610,000 | 140,000 | - |
| 4 | Vizibilitet | | | | | | | |
| 4.1 | Vizibiliteti i projektit | lump sum | 1 | - | - | - | - | - |
| | Sub total | | | | - | - | - | - |
| I. | Kostot Direkte(No. 1.-4.) | | | | 4,966,498 | 4,515,000 | 451,498 | - |
| II. | Shpenzimet e përgjithshme3 (maksimumi 10% e kostove totale direkte të Projektit) No.5 | | | | | | | |
| | TOTAL (e.) | | | | 4,966,498 | 4,515,000 | 451,498 | - |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Muhamet Shendaj dhe Mirza Be dhe mban nga dërguesi nr. 807/13 pr
date 12.02.2024 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) social

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyres prot. 490B/1 date 13.02.2024

Praktika u drejtohet për administrim:

- Znj/Z Drejtori Shkencave
- Znj/Z Sektorit Integruar
- Znj/Z Dr. Burimare Myrzoze
- Znj/Z Dr. Ruzdimit Social

me porosinë:

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë _____

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: _____

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Peshkopi, më 13.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E ZHVILLIMIT PËR MBROJTJES SOCIALE

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 807/ Prot
13

Tiranë, më 02.02.2024

Lënda: Njoftim

BASHKISË DIBËR ✓

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përgjigje të kërkesës suaj Nr. 4968 prot., datë 22.12.2023, protokolluar me tonën Nr. 3903/26 prot., datë 26.12.2023, ndaj thirrjes për aplikim në kuadër të Fondit Social 2024, ju njofton se:

Komisioni i vlerësimit të kërkesave për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka shqyrtuar kërkesën e Bashkisë Dibër, për ofrimin e Shërbimit Social Lëvizës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Dibër, e cila është përzgjedhur për mbështetje dhe financim, në kuadër të Fondit Social.


Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të financojë kontributin e kërkuar nga Fondi Social deri në 90% të kostos së projektit për vitin 2024, për 11 muaj për periudhën shkurt - dhjetor 2024, sipas rivlerësimit të zërave buxhetor nga Komisioni, në masën 4,515,000 lekë.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ka detyrimin ligjor, për të raportuar çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në kuadër të bashkëpunimit, kërkohet raportimi në kohë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe të bëhet me dije Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi zbatimin e projektit, si dhe përdorimin e regjistrit elektronik.

Nga ana juaj kërkohet, që të gjitha strukturat përgjegjëse në administrimin tuaj, të kryejnë procesin e vlerësimit dhe referimit të rastit, në ofrimin e këtij shërbimi, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raportimin e të dhënave çdo muaj. Mos përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, do të kushtëzojë vijimin e financimit në kuadër të Fondit Social, nga ana Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



| | | 600 | 601 | 602 | SHUMA |
|---|--|------------------|-----|----------------|------------------|
| 7 | <p>Bashkia Diber</p> <p>Sherbim social levizës për fëmijet me AK në Diber. "Përmirësimi i shërbimeve dhe rritja e mirëqenjes sociale për fëmijet me AK në Diber"</p> <p>5 punonjës të angazhuar në implementimin e këtij projekti</p> <p>1 Punonjës social (koordinon edhe aktivitetet dhe menaxhimin e projektit) 1 Logopedist, 1 Fizioterapist, 1 Psikolog, Shofer për shërbimin levizës</p> | 825,000 | | | 825,000 |
| | 1 Psikologe - paga 75,000 leke | 825,000 | | | 825,000 |
| | 1 Punonjese sociale- paga 75,000 leke | 825,000 | | | 825,000 |
| | 1 Fizioterapist - paga 75,000 leke | 825,000 | | | 825,000 |
| | 1 Logopedist - paga 75,000 leke | 825,000 | | | 825,000 |
| | 1 Shofer - paga 55,000 leke | 605,000 | | | 605,000 |
| | Shpenzime operative: | | | | |
| | * Trajtime për stafin e rekrutuar 100,000 leke | | | | |
| | * Takime me insitucionet lokale për rrijntegrimin e fëmijëve me AK 100,000 leke | | | | |
| | * Aktivitete të ndryshme për të adresuar problematikat 200,000 leke | | | | |
| | * Uniforma për stafin 30,000 leke | | | | |
| | * Karburant -180,000 leke | | | 610,000 | 610,000 |
| | TOTALI | 3,905,000 | | 610,000 | 4,515,000 |



Nr. 1337, datë 16.02.2024



Nr. 714, datë 21/02/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

SHËRBIMIT SOCIAL SHITETËROR

Dhe

BASHKISË DIBËR

**PËR
ZBATIMIN E PROJEKTTI "SHËRBIM SOCIAL LËVIZËS PËR FËMIJËT ME
AFTËSI TË KUFIZUAR - PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE DHE RITJA E
MIRËQENIES SOCIALE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË
DIBËR"**

MBËSHITETUR FINANCIARISHT NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL.

Sot më datë ____/____/2024 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

Shërbimi Social Shtetëror është person juridik publik që ushtron veprimtarinë në bazë të Ligjit nr 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 135 datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar, përfaqësuar nga Z/Znj. Reme Xholi, Drejtor i Përgjithshëm, me adresë: Rruga e Durrësit, Nr 1001, Tiranë, (më poshtë referuar edhe si "SHSSH")

dhe

Bashkia DIBËR me adresë: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, përfaqësuar nga Z. Rahim Spahiu, Kryetar Bashkie.

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i angazhimeve dhe përgjegjësiive të ndërsjellta midis palëve, për të garantuar zbatimin e programit financiar të Fondit Social, sipas projektit të miratuar.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 150 datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror".

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është:

- të institucionalizojë bashkëpunimin ndërmjet palëve, me qëllim përfortimin e mëtejshëm të punës në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare të integruara
- të përmirësojë shërbimet ekzistuese, si pjesë e planeve sociale të bashkive, për të përmbushur në kohë dhe më cilësi nevojat e gjithë grupeve vulnerabël.

Neni 4
Angazhimet dhe detyrimet e palëve

1. Shërbimi Social Shtetëror, (SHSSH), angazhohet:

- a) të realizojë procedurën e disbursimit të fondeve të planifikuara për financimin e projektit të paraqitur dhe të miratuar nga Komisioni i Vlerësimit të Fondit Social, pranë MSHMS, bazuar në kërkesën e paraqitur dhe kriteret e përcaktuara, sipas VKM Nr. 150, datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror"
- b) të ndjekë ecurinë e shpenzimeve çdo katër muaj, bazuar në raportimin e bërë nga Bashkia, mbi realizimin/implementimin e projektit;
- c) të informojë dhe të vërë në dispozicion protokollat dhe manualat për zbatimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve, në përputhje me projektin e miratuar;
- d) të sigurojë, monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimit nga ofruesi i shërbimit.

2. Bashkia DIBËR angazhohet:

- a) Të deklarojë se nuk ka përfituar ose nuk është duke përfituar financim nga ndonjë donator tjetër, për të njëjtin projekt;
- b) të sigurojë zbatimin e projektit "Shërbimi social fëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara - Përmirësimi i shërbimeve dhe rritja e mirëqenies sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara në Dibër" në përmbushje të standardeve të ofrimit të shërbimeve në sipas Udhëzimeve në fuqi për standardet e shërbimit
- c) të sigurojë dhe të vërtetojë, nëpërmjet Programit Buxhetor të bashkisë lidhur me Shërbimet Sociale, parashikimin e fondit për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimit, sipas përqindjes së kontributit të bashkisë, të parashikuar dhe të miratuar nga Këshilli Bashkiak, reflektuar në tabelën buxhetore, që shfaqet në aplikimin;
- d) të sigurojë punësimin e një ekipi profesionistësh multidisiplinar, për të ofruar me cilësi shërbimin ndaj përfituesve;
- e) të realizojë menaxhimin dhe referimin e rasteve/përfituesve, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve Shoqërore;
- f) të mos ndryshojë llojin e ofrimit të shërbimit, për të cilin është përfituese e këtij fondi të mbështetjes, ose të tjetërsoj objektin e veprimtarisë së shërbimit, në veprimtari të paligjshme, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

- g) të sigurojë raportimin e ecurisë së projektit, çdo katër muaj dhe si herë kërkohet nga MSHMS dhe SHSSH, deri në përfundimin marrjes së fondit nga buxheti qendror;
- h) të sigurojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse, në varësi të Ministrisë, gjatë çdo procesi monitorimi apo auditimi (performancë dhe financiar).

Neni 7

Komunikimi mes palëve dhe Personat e Kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit (të dhënat e plota), janë si vijon:

Për Bashkinë: Z. Rahim Spahi

Për SHSSH: Znj. Reme Xholi

2. Në rast të ndryshimit të njërit nga këta persona, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike, për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 8

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje lidhet për një afat të përcaktuar 3 vjeçar, 2024-2026, me të drejtë rinovimi.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe kushtet e zgjidhjes së marrëveshjes

1. Në rastin e mospërbushjes së një nga detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 6, përjashtuar detyrimet e parashikuara në shkronjat e) dhe f), të kësaj Marrëveshjeje, nga Bashkia, Komisioni i Vlerësimit të Fondit Social bën vlerësimin e situatës dhe merr vendimin për rishikimin e masës së financimit.
2. Në rastin e mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara, në shkronjat e) dhe f), të seksionit të pikës 2 të nenit 6, Komisioni merr vendimin për zgjidhjen e menjëhershme të kësaj marrëveshjeje.
3. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Fondit Social është i formës së prerë dhe nuk mund të anulohet.
4. Me ndërprenjen dhe zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje, SHSSH nuk ka asnjë detyrim për vijuesinë e financimit për realizimin e projektit të paraqitur nga Bashkia.

5. Në rast të mosmarrëveshjeve, që mund të lindin mes palëve dhe që nuk zgjidhen me frymën e mirëkuptimit apo me bisedime ndërmjet tyre, palët kanë të drejtën t'i adresohen për zgjidhje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 10

Ndryshimi i Marrëveshjes

Marrëveshja mund të ndryshohet, vetëm nëpërmjet paraqitjes së kërkesës me shkrim nga secila prej palëve nënshkruese.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Palët angazhohen të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje, me qëllim realizimin e veprimtarive të projektit në interes të përfituesve.
2. SHSSH nuk mban përgjegjësi ndaj bashkisë për dëme ose humbje, të shkaktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, nga ofrimi i shërbimit ose nga zbatimi i rekomandimeve të bëra nga ofruesi i shërbimit.
6. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR SHSSH

ZNJ. REME XHOLI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



PËR BASHKINË

Z. RAHIM SPAHË

KRYETAR

AUTORIZUET
Z. KRYETARI
Tirane
REDA
REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR